



*MINISTRIA E ARSIMIT DHE UNIVERSITETI I KERKIMIT
DREJTIMI RAJONAL I TOSKANES
ZYRA E TERRITORIT TE AREZOS*

*ISTITUTI GJITHPERFSHIRE
KOPESHTI, SHKOLLA FILLORE DHE E MESME
E CIVITELLA IN VAL DI CHIANA*



**UDHEZIM PER NJOHJEN DHE PJESEMARRJEN NE SHKOLLE
PER FAMILJET E NXENESVE TE HUAJ**

PER SHKOLLAT FILLORE PRIMARE E SEKONDARE TE GRADES SE DYTE

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME	2
2. NJOFTIME MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHKOLLES	3
3. RAPORTI SHKOLLE -FAMILIE	6
4. THIRRJA DHE GJYKIMI DISIPLINAR	7
SIGLAT ME FREKUENTE QE PERDOREN NE BOTEN E SHKOLLES	8

1. INFORMAZIONI TE PERGJITHSHME

ORGANIZIMI I SISTEMIT SHKOLLOR NE ITALI

- Cerdhja (3 muaj- 3 vjec) jo e detyrueshme (per informacione drejtoheni në Komunë)
- Kopeshti 3 – 5 vjec (jo i detyrueshëm)
- Shkolla primare 6-10 vjec (e detyrueshme)
- Shkolla sekundare e grades 1° nga 11-13 vjec (e detyrueshme)
- Shkolla sekundare e grades 2° nga 14 deri 18-19 vjec (e detyrueshme deri ne 16 vjec)
- Universiteti (jo i detyrueshem)

ZGJATJA E VITIT SHKOLLOR

- Viti shkollor fillon ne mes te shtatorit e mbaron ne mes te qershorit
- Kopshti mbaron ne 30 qershor
- Datat e regullta te nisjes dhe mbarimit te vitit shkollor, vendosen nga viti ne vit.

PERIUDHA E PUSHIMEVE

Krishtlindjet (rreth 15 dite)

Pashket (rreth nje jave)

1 nentori-8 dhjetori-25 prilli-1 maji- 2 qershori- Shenjti i vendit ku banoni.

Cdo shkolle i cakton ditet e tjera te pushimeve vete, i vendos keshilli i insitutit e i shkruan ne KALENDARIN E SHKOLLES: ditet e mesimit, nuk mund te jene me pak se 200.



REGJISTRIMI NE SHKOLLE

Normalisht behen ne janar dhe fillojne mesimin ne shtatorin qe vjen.

Rrall here (per ardhjet e pa programuara) regjistrimet mund te behen:

- edhe gjate vitit, kur prindi e di qe nxenesi do te vije ne Itali.
- edhe gjate vitit, kur nxenesi ka ardhur ne Itali.



DOKUMENTET QE DUHEN

- certifikata e lindjes
- certifikata e vaksinimit
- certificata e shkolles nga e cila vjen (emri dhe tipi i shkolles, klasa qe ka bere, deftesa; lendet qe ka studiuar, dhe informacione te tjera te dobishme, etj.)

Ne qofte se prindrit i kane keto dokumenta, mund te bejne nje autocertifikate.

Dokumentat shkollore duhet te jene te perkthyer ne italisht per kete prinderit duhet te drejtohen perkthyesve ne Centro di Documentazione te Arezos, ne Ambassade/ Konsullaten e vendit te tij o ne organe te tjera te njohura

Eshte e domosdoshme qe prindrit ti sjellin mesuesve te shkolles fletoret dhe librat e nxenesve

DOKUMENTET QE PRINDRIT DUHET TE PLOTESOJNE PER SHKOLLEN

- kerkesen e regjistrimit ne modelin e paraqitur nga shkolla
- kerkesen per mesimin e fese te krishtere o te ndonje aktiviteti tjeter.
- zgjedhjen e modelit te orarit javor (nqs modelet jane me shume se nje)

KERKESA TE TJERA QE PRINDRIT MUND TI KERKOJNE SHKOLLES

- kerkesa per hyrje me perpara dhe daljen me vone
- kerkesa per sherbimin e transportit shkollor nga shtepia (zyra e shkolles ne Komune)
- kerkesa per te modifikuar menune e ushqimit per egzigenca te shendetit apo te fese.

NDIHME EKONOMIKE PER FAMILJET

- Librat e shkolles jane falas, ne shkollen e mesme librat blihen nga prinderit. Familjet qe kanë të ardhurat e ulta (deklarimi ISEE) mund të kenë nje ndihmë ekonomike nga Komuna si per te blere librat edhe si per te blere materiale didaktike, branda kohes se bandes vjetore rehxionale.
- Menca dhe transporti jane te paguara nga familjet : familjet me te ardhura te pakta mund te kene reduktime (drejtohuni Komunes).

NDIHME PER STUDENTET E SEMURE

Femijeve me probleme fisico o psiqike ju kushtohet kujdes i vecante dhe i behen lehtesime :

- kane nje mesuese ndihme
- nje ndihmese per nevojat personale (nqs ka veshtiresi)
- falas per gjysem o te tere transportin (kerkoni ne Komune)
- per ndihma te tjera (kerkoni ne zyren e sekretarise)

2. NJOFTIME MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHKOLLES

ORGANET KOLEGJALE

Shkolla italiane shikon e vlereson dhe prezencen e prinderve dhe studenteve ne jeten shkollore nepermjet Organeve Kolegjale.

Organet me te rendesishme jane:

- **Keshilli i Istitutit**, Organ i pergjithshem i organizimit dhe programimit te shkolles, eshte i perbere nga 8 mesues, 4 prinder, 4 nxenes, Drejtori i shkolles, e 2 pjesmares te personelit ATA (Administrativ, Teknik dhe Ndhimes).

- **Keshilli i mesuesve**, eshte i perbere nga te tere mesuesit e shkolles presanton diskuton dhe punon mbi aspektin mesues –edukativ te jetes shkollore. Ne vecanti perpunon POF (Plani i Ofertes se Trajnimit) te Istitutit.
- **Keshilli i interseksionit** (kopshti): 1 prind per cdo seksion
- **Keshilli i interklases** (shkolla fillore): 1 prind per nje klase
- **Keshilli i klases** (shkolla 8-vjecare): 4 prinder per klase

NE SHKOLLE PUNOJNE KETO FIGURA.

- **Drejtori i shkolles**, Ka si detyre te drejtoje e organizoje shkollen. Ai ju pret ne takime.
- **Mesuesit** japin lendet dhe aktivite e pershkruara nga plani i studimit dhe mbajne kontakte me familjet.
- **Segretaria** punon mbi aspektet burokratike te organizimit: kjo drejtohet nga drejtori i sherbimit te pergjithshem te organizimit (DSGA) dhe perbehet nga shume persona te administrates. Njeri prej ketyre organizon raportet me familiet e nxenesve te huaj.
- **Punetoret shkollor**, kontrollojne nxenesit kur hyjne e deri sa dalin, presin personat qe i drejtohen shkolles, pastrojne dhe bejne pune te tjera, por nuk japin mesim.



LISTA LENDEVE QE MESOHEN

NE KOPESHT

Fushat e eksperiences

- Vetvetja dhe tjetri
- Trupi ne levizje
- Gjuha, krijimtaria, ekspesioni
- Diskutimet dhe fjalet
- Njohja e botes

SHKOLLA FILLORE

Lendet jane te organizuara ne tre fusha:

1. Fusha gjuhësore – artistike - ekspresive

- Italishtja
- Gjuha e huaj komunitare (anglisht)
- Musika
- Arti dhe imagjinimi
- Trupi, levizjet sport

2. Fusha histori - gjeografi

- Histori

- Gjeografi
3. *Fusha matematik – shkence - teknologji*
- Matematike
 - Shkenca natyrore dhe eksperimentale
 - Teknologjia

SHKOLLA SECONDARE E GRADES SE II

- Italisht
- Histori
- Gjeografi
- Dy gjuhe te huaja (anglisht, frengjisht)
- Matematike
- Shkenca natyrore dhe eksperimentale
- Teknologji
- Art dhe imagjinim
- Musika
- Trupi, levizja Sporti




NDIHME PER TE KUPTUAR ITALISHTEN

Per studentet e huaj qe nuk njohin italishten o e njohin pak, shkolla organizon ore mesimi speciale te italishtes me programe te vecanta. Ne fund te vitit shkollor studenti duhet te arrije objektivat e domosdoshme e te percaktuara gjate rruges speciale shkollore.

Nxenesi dhe familja duhet te impenjohen te bashkepunojne me shkollen per te arritur obiekativat qe me pare jane fiksuar.

VLERESIMI



Viti eshte i ndare ne dy periudha (1° katermujorsh dhe 2° katermujorsh)

Ne fund te periudhes te 1° e te 2° i jepen familjes deftesa . Ne deftese jane gjithë rezultatet lende per lende dhe nje gjykim i pergjithshem. Vleresimi ne secilen lende eshte nga **1 deri ne 10**.

Vleresimi i pergjithshem jep nje profil te nxenesit ne sjellje, ne raportet me te tjeret, pjesemarrjen ne jeten shkollore, impenjimet, progreset dhe autonomi–pjekuri.

Eshte e konsideruar kaluse nota 6. Nxenesi qe rezulton ngeles ne shumicen e lendeve perserit klasen.

Deftesa e katermujorshit te 1° dhe te 2° duhet te firmoset nga prinderit ose nga personi qe ushtron autoritetin prinderor.



DALJE, VIZITA DHE UDHETIME (ESKURSIONE)

Jane aktivitete mesimore te nevojshme qe shikojne daljen nga shkolla e te vizitojne vende dhe aktivitete te kenaqeshme e te duhura. Per keto iniciativa eshte e domosdoshme kerkesa dhe autorizimi i familjeve dhe zakonisht paguhet nga prinderit.

Cdo shkolle parashikon ulje per familjet me te ardhura te pakta.

MUNGESAT DHE JUSTIFIKIMET

- **Ne fillim te vitit (o kur nxenesi vjen) i jepet nje libereze per arsyet qe duhen te firmosen nga prinderit direkt ne sekretari.**
- Mungesat duhet te jene te justifikuara ne libezen e mungesave.
- Mungesat per semundje, me shumë se 5 ditë, duhet të jenë të justifikuara nga doktori me një certifikatë.
- Prinderit janë të detyruar të sigurojnë frekuentimin në shkollë të fëmijve të tyre (të paktën dy të tretat e numrit të përgjithshëm të orëve)
- Fëmijët mund të mungojnë për arsye shëndetësore ose për arsye serioze duke komunikuar në shkollë

3. RAPORTI SHKOLLE -FAMILIE



TAKIM ME MESUESIT

Takimet i prinderve me mesuesit jane shume te rendesishem e organizohen:

- ne fillim te vitit per te informuar per situaten e fillimit.
- gjate vitit (zakonishte ne nentot- dhjetor e ne mars –prill) per dhenien e defteses se katermujorshit te 1° (ne shkurt) e te katermujorshit te 2° (ne qershor).
- prinderit mund te takojne mesuesit edhe ne menyre te vecante: per kete eshte kalendari i vecante i oreve dhe diteve kur mesuesi pret.
- mesuesit, per te komunikuar me familjet, mund te lajmerojne prinderit duke fiksuar nje takim.

LAJMERIMET QE SHKOLLA I BEN FAMILJEVE

- Njoftime per pushimet shkollore o nderprerjen e mesimit
- Ndryshimin e orarit te hyrjes e te daljes
- Kerkesa e autorizimit per daljet, vizitat udhetimet
- Njoftimi per dhenien e defteses
- Kerkesa per takim me prinder

KERKESA QE I BEN FAMILJA SHKOLLES

- Kerkese per takim me mesuesin
- Kerkesa me arsye per dalje me perpara o me vone
- Kerkesa per te mos bere gjimnastike

KONTRIBUT I KERKUAR FAMILJEVE

I kerkohet kontribut familjeve per:

- spesa per udhetime/vizita/ dalje
- sigurimin e femijeve
- integrim ne spezat per konsumim didaktik

Janë parashikuar lehtesime per familjet me shume femije te regjistruar apo me probleme ekonomike.

4. THIRRJA DHE GJYKIMI DISIPLINAR

Ne baze te gabimit te bere nga nxexesi, shkolla merr keto masa:

- thirrje verbale
- shkruhet ne ditar per prindrit
- shkruhet ne regjister
- shkruhet ne regjister e lajmerohet drejtoria
- ndalim nga shkolla per 15 dite
- ndalim nga shkolla mbi 15 dite (per gabim shume te rende)

SIGLAT ME FREKUENTE QE PERDOREN NE BOTEN E SHKOLLES

- M.I.U.R.** (Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit)
- U.S.R.** (Zyra Shkollore Rexhionale)
- U.S.P.** (Zyra Shkollore Provinciale e Arezos)
- D.S.** (Drejtor i Shkolles)
- DSGA** (Drejtor i Sherbimit te Pergjithshem e Administrativ)
- A.T.A.** (Personel Administrativ, Teknik dhe Ndhimes)
- POF** (Plani i Ofertave te Trajnimit)
- R.I.** (Regullorja e Institutit)
- OO.CC.** (Organet qe marrin pjese ne jeten shkollore:
Parashikojne pjesmarrjen e prinderve dhe nxenesve)
- C.I.** (Keshilli i Institutit)
- C.D.**(Kolegji i Mesuesve)
- C.d.C.** (Keshilli i Klases)